



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 5018 Prot

Shkodër, më 31. 3 .2022

VENDIM
Nr. 188, datë 31. 3 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS STANDARTE TË VEPRIMIT, PËR
“ZBATIMIN, NDJEKJEN, DHE LIKUIDIMIN E POJEKTEVE TË REALIZUARA
PËRMES PROCEDURËS SË METODOTOLOGJISË LOD”**

Në mbështetje të nenit 8, 9 germa gj të nenit 64, të Ligji nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar; Ligji Nr. 45/2016 Për vullnetarizmin; VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”; VKB nr. 18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi ‘Sport dhe Argëtim’, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të klubit sportiv ‘Vllaznia’; VKM nr.354, dt 29.8.1994 "Për shpërblimin e cilësisë të veprimtarive sportive, për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime te tjera sportive”, i ndryshuar; VKM nr 687 datë 14.11.2018 “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, të ndryshuar; Memorandumit të mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe UNDP Albania nr. prot 15973, datë 22 shtator 2021;

Vendimit nr. 96, datë 20.03.2017 Për miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër; Relacionit të hartuar nga Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit me nr. 969/b prot, datë 31/03/2022.

VENDOSA

1. Miratimin e procedurës standarte të veprimit, për “Zbatimin, ndjekjen, dhe likuidimin e projekteve të realizuara përmes procedurës së Metodologjisë LOD”, sipas materialit bashkëlidhur (137 faqe).
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër, sikurse cituar në materialin bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Voltana Ademi

